

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 7 EURO do të jetë monedha zyrtare e Shqipërisë pas hyrjes në BE! Priligi për Bankën e Shqipërisë hidhet për Konsultim Publik
- 2 Plan i Rritjes
- SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritët 'thithja' e 215 milionë eurove nga
- 3 e tretë në Serie A
- Pritet vetëm zyrtarizimi, Mërgim Vojvoda të Comoa për Udinosen! Përvoja
- 4 gjithë Shqipëria, ka firmosur masterplanin për zhvillimin e Zvërnecit
- 'Mezi pres Saliun', Balla: Kam dokumentin që Berishën do ta qeshë përse kjo ndeshje vlen
- 5 Botërori 2026/ Franca dhe Anglia do të përballen në finalen e vogël, katër arsyet

Kronikë

Shkodër/ 40-vjeçari vritet me armë zjarri brenda automjetit! Dyshime për hakmarrje, i vëllai në 2017-ën ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh dhe çështje nderi

40-vjeçari Aleksandër Koçeku ka mbetur viktimë e një sulmi me armë zjarri në Dukagjin të Shkodrës, teksa po udhëtonte me automjetin e tij. Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur për hakmarrje, pasi viktima është vëllai i Artan Koçekut, i cili është në burg për vrasjen e Angjelin Shkambit në vitin 2017.

■ I vëllai i viktimës 9 vite më parë ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh e një çështje nderi

Shkodër/ Vritet me armë zjarri brenda automjetit Aleksandër Koçeku, Report TV



Watch on

[Sh] Redaksia 11 Korrik, 20:02 | Përditësimi: 12 Korrik, 09:09

Share Post

A A

Një vrasje me armë zjarri ndodhi mbrëmjen e së shtunës në Dukagjin të Shkodrës. Viktimë mbeti shtetasi Aleksandër Koçeku, rreth 40 vjeç.

Burime për Report Tv bëjnë të ditur se ai u qëllua disa herë me armë zjarri, duke mbetur i pajetë në vend. Koçeku po lëvizte nga Kiri i Dukagjinit drejt Prekalit për në Shkodër, ku në afërsi të fshatit Lin, u qëllua me breshëri plumbash.

Autorët, siç duket e kanë ruajtur viktimën dhe në një segment rrugor malor, ku ka shumë pak lëvizje dhe duke përfutur nga errësira dhe mungesa e kamerave, e kanë vrrarë.

[Sh] LEXO EDHE: I riu plagos me thikë 32-vjeçarin në Shkodër, i vëllai tenton të vrasë autorin, vihet në pranga! Në kërkim 18-vjeçari (VIDEO)

Familja Koçeku ishte në gjak dhe këtë e konfirmojnë edhe të afërmit. Viktima është vëllai i Artan Koçekut, i cili është në burg për vrasjen e shtetasit Angjelin Shkambi në dhjetor të vitit 2017.

“Babin e tij e kam djalë xhaxhai. Konflikti e dinë të gjithë që kemi pasur. Kemi një në burg për atë punë që ka pasur gjak borxh diku. Merrej me punë të shtëpia kryesisht, me një furrë buke, punonte në Shkodër të dhëndri i vet”, tha mes të tjerash, Mark Koçeku, një i afërm i viktimës.

Shkak për vrasjen e Angjelin Shkambit asokohe dyshohet të ketë qenë një borxh prej 40 mijë eurosh, ndërkohë që nga dosja hetimore rezultonte se Angjelin Shkambi kishte krijuar një raport intim me motrën e vëllezërve Koçeku, ndërkohë që, nga ana tjetër, ishte i fejuar me një vajzë tjetër.

Për të kryer vrasjen, Artan Koçeku kishte marrë leje nga burgu i Peqinit, pasi ishte arrestuar për një tjetër vepër penale dhe se i kishte kërkuar Angjelin Shkambit takim nëpërmjet Facebook.

Ndërkohë Policia dhe grupi hetimor kanë shkruar në vendngjarje dhe kanë mbledhur provat për të bërë të mundur identifikimin dhe arrestimin e autorit/autorëve, si dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 22:47 Vrasja e 40-vjeçarit në Shkodër për hakmarrje, i vëllai i viktimës 9 vite më parë ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh e një çështje nderi



Artan Koçeku dhe Angjelin Shkambi

Në Dukagjin të Shkodrës, u ekzekutua mbrëmjen e sotme me armë zjarri 40-vjeçari Aleksandër Koçeku. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive hakmarrje lidhur me një tjetër vrasje të ndodhur 9 vite më parë.

Artan Koçeku, i vëllai i Aleksandër Koçekut, në dhjetor 2017, ka ekzekutuar me 10 plumba Angjelin Shkambin. Shkak thuhet të jetë bërë një borxh prej 40 mijë eurosh. Në dosjen hetimore, del se Angjelin Shkambi kishte krijuar një raport intim me motrën e vëllezërve Koçeku, ndërkohë që, nga ana tjetër, ishte i fejuar me një vajzë tjetër.

Për të kryer vrasjen, Artan Koçeku kishte marrë leje nga burgu i Peqinit, pasi ishte arrestuar për një tjetër vepër penale dhe se i kishte kërkuar Angjelin Shkambit takim nëpërmjet facebook. Hetimi në atë kohë tregoi se Shkambi merrej me kultivim të lëndëve narkotike, shpërndante fara hashashi dhe jepte para borxh.

K.B/Shqiptarja.com

Share

R.Xh/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Prekal vrasje Shkoder arme zjari Aleksander Koceku Vasel Koceku Pavlin Preka Klaudio Lisaj policia

Komento

Komente

Ndalohe repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

[SH] Sondazhi i ditës: Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare? 14 Korrik, 12:01

Të drejtë Të gabuar Nuk e di


Lajme të tjera

- 

Abuzimi me çmimet e shezlongëve, bashkia Shkodër kontrollon në plazhin e Velipojës! Penalitete për bizneset që abuzojnë

16 Korrik, 11:55
- 

Do i shiste 4 pistoleta grupit kriminal në Sarandë, arrestohet i riu! Momenti kur policia e ndjek nga pas dhe e rrethon në tunelin e Skërficës (VIDEO)

16 Korrik, 10:04
- 

Iu gjenden në banesë 4 armë zjarri dhe municion, arrestohet 21-vjeçari në Shkodër (VIDEO)

16 Korrik, 08:53
- 

Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI)

14 Korrik, 10:10
- 

Vrasja e 13-vjeçares shqiptare në Itali në 2024-ën, ish-i dashuri pranon krimin: Isha unë që e shtyva Aurorën nga ballkoni


14 Korrik, 08:44
- 

Atentati në Bërksullë nga vrasës me pagesë! Autori e qëlloi Edmond Sulën me një plumb në kokë, pistë hetimi konflikti për shit- blerje pronash

Sokol Dema

13 Korrik, 11:27
- 

Vrau bashkëshorten për xhelozë, Gjykata e Shkodrës lë në burg 64-vjeçarin! Asnjë fjalë në seancë (VIDEO)


13 Korrik, 10:34
- 

Mbeti viktimë e një atentati në Vorë, Report Tv siguron foton e 50-vjeçarit të ekzekutuar në derë të shtëpisë

12 Korrik, 23:08
- 


Ura e Mesit në Shkodër mahnit turistët e huaj: Vendi më i bukur në botë, me njerëzit më të mirë (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 14:21
- 

Ekzekutimi i 40-vjeçarit në Shkodër, policia sekuestron 25 gëzhoja në vendin e ngjarjes! Pista e hetimit, gjakmarrja (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 10:21
- 

U quajt 'Ura e Vezirit', për nder të Mehmet Pashë Bushatit, historia e panjohur e urës së famshme që komunistët i vunë minat në '78-ën

Ali Hasani

12 Korrik, 09:57
- 

Bjorn Runa: Politika që na shpëtoi, ndërsa flisnim për politikë

Bjorn Runa

12 Korrik, 09:20

× [Sh] Lajmi i fundit



SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritët 'thithja' e 215 milionë eurove nga Plan i Rritjes

16 Korrik, 16:04



×

[Sh]

.com

Lajmi i fundit



SASPAC përmbush detyrat për qershorin, pritet 'thithja' e 215 milionë eurove nga Plani i Rritjes

16 Korrik, 16:04